



6

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Datë 11.06.2026

RAPORT VENDIMMARRJEJE

Projekt-vendimin *(titulli i projektvendimit* PËR MIRATIMIN E NGRITJES DHE FUNKSIONIMIT TË “QENDRËS PËR SHËRBIME MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN” ME MBËSHTETJEN NGA PROGRAMI I FONDIT SOCIAL TË BUXHETIT TË SHTETIT PËR VITET 2026-2028 DHE BUXHETI I BASHKISË DURRËS.

Baza ligjore:

Në zbatim të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Deklaratën e Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën e të Drejtave të Fëmijëve, ligjit nr. 121/2016, “Për Shërbimet e Përkujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, VKM-së nr. 658, datë 17.10.2005 “Për Standartet e Shërbimeve Shoqërore”, Udhëzimin nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e Standarteve të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Qendrat Komunitare Shumëdisiplinore”, Planit Social Vendor 2025–2028 të Bashkisë Durrës, Marrëveshjen e bashkëpunimit Nr. 2420 prot, datë 18.02.2026 të lidhur ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social Shtetëror për zbatimin e projektit: “Qendër për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen”, mbështetur financiarisht nga programi i Fondit Social.

Propozimi nga kryetari/këshilltarët/tjetër *(Çfarë propozohet në projektvendim):*

Kryetari i bashkisë, sipas relacionit të hartuar nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, i propozon Këshillit Bashkiak të shqyrtojë konform akteve ligjore dhe të vendosë:

1. Ngritjen dhe Funkcionimin e Qendrës për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” me një strukturë prej 5 punonjësish.
2. Fondin e shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve operative për Qendrën për “Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen” për vitin 2026 është 5,241,680 lekë e financuar nga Fondi Social, alokuar nga Buxheti i Shtetit, i ndarë si më poshtë vijon:
 - Për paga (llogaria ekonomike 600) 4,308,128 lekë.

- Për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (llogaria ekonomike 601) 708,384 lekë.
 - Për shpenzime operative (llogaria ekonomike 602) 225,168 lekë.
3. Niveli i pagave të këtyre punonjësve është sipas lidhjes nr. 5, të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.17, datë 02.04.2026 "Për miratimin e nivelit të pagave për punonjësit e institucioneve në varësi të Bashkisë".
 4. Veprimet financiare të kësaj qendre do të kryhen nga nëpunësi zbatues i nivelit të dytë pranë Qendrës Ditore të të Moshuarve.
 5. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria e Buxhetit, Qendra Ditore e të Moshuarve, Qendra për Shërbime Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen (SHMFF).

Analiza Financiare/ Buxheti total/natyra e financimit (të ardhurat e veta, transferta etj):

Fondi Social, alokuar nga Buxheti i Shtetit.

Drejtorja/Spektori përgjegjës që ka përgatitur materialin:

Drejtorja e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Impakti social/grupet që preken:

Banorët e Bashkisë Durrës.

A është objekt konsultimi: (PO/JO)

JO.

Komisioni i përhershëm/përkohshëm i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit, u mbledhë më datë 11.06.2026, dhe shqyrtoi pikën nr. 6 të rendit të ditës, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij.

Komunikimi midis administratës dhe komisionit i përhershëm/përkohshëm:

Kryetari i Komitetit bashkiak mbledhës.

Përfundimi i bashkimit të komitetit bashkiak mbledhës të rendit të ditës.

Pas diskutimit të përfunduar në bashkisë të gjithë anëtarët e Komitetit të bashkisë mbledhës janë dakorduar të kalojnë për krahun me të drejtë në mbledhje.

Për sa më sipër, pas shqyrtimit, të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash, vendosi:

T'i propozojnë Këshillit Bashkiak:

- a- Kalimin e projektaktit në mbledhjen e Këshillit për vlerësimin e mëtejshëm dhe për shqyrtim
- b- Miratimin e projekt aktit
- c- Refuzimin e miratimit të projektaktit
- d- Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
- e- _____

Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqënies Sociale dhe Mosdiskriminimit

Kryetar

Edlira Shemsi

Zv/Kryetar

Florian Tahiri

Sekretar

Bledar Prizreni

Anëtar

Xhiliola Doçi

Anëtar

Denis Lika